



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER BELINDA V. ÇELAJ  
ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI,  
NR.3/118  
TEL: 0692077776

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 461

Nr. koleksioni: 181

Tirane më 18/02/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2022050310019552612

\*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A20220503 10019552612

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**  
( TË SHOQËRISË “GMA ALBANIA” SH.P.K)

Sot, më datë 18/02/2022 , para meje Notere BELINDA V. ÇELAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.3/118, u paraqit personalisht:

**SHITES:**

GABRIELLA MALINCONICO, atësia CARLO, , shtetase Italiane, lindur në Piedimone Matese Itali dhe banues në Itali, lindur më 29/07/1983, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr.YA8681372,.

**BLERES:**

Fabio Nicola De Santis, shtetas Italian, lindur në Caserta dhe banues në Itali, me adresë Caserta lindur më 08/04/1970, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me me dokument italian me nr. Personal YA8102016, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

*Kushtet paraprake:*

- i. Shitesi është ortak me numrin e pjesëve 1 (një) dhe pjesëmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind) në shoqërinë “GMA ALBANIA” sh.p.k, e regjistruar rregullisht si person juridik me datë 06/08/2018, pranë QKB (Qendrës Kombëtare e Bisnesit), me NUIS: L82006005B
- ii. ,me zyrë qendrore në adresën Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", Zk 8270, Pallati Nr. 68, Kati 4, Ap 15 ,Tirane Në zbatim, të Nenit 7- Transferim i kapitalit të Statutit të shoqërisë dhe Ligjit nr.9901 dt. 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i përditesuar, pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statutin e shoqërisë.
- iii. Shitesi pjesën e tij nominative 100% (njëqind përqind), që zotëron në shoqërinë “GMA ALBANIA” sh.p.k, dëshiron t’ia shese z.Fabio Nicola De Santis, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë kontratë.
- iv. Bleresi, i cili do të pranojë blerjen e pjesës që i korrespondon 100 % (njëqind përqind) të pjesëmarrjes në përqindje, që bleresi zotëron në shoqërinë “GMA ALBANIA” sh.p.k, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë kontratë.

*Shitesi dhe Bleresi janë referuar më poshtë individualisht si “Pala” dhe sëbashku si “Palët”.*



A2022050310019552612

**Neni 1**  
**Objekti i Kontratës**

1.1 Shitesi dëshiron të shese në këtë kontratë me vullnet të lirë e të plotë në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Statutit të Shoqërisë, kapitalin që zotëron për pjesën e saj, me vlerë nominale prej 10 000 leke (*dhjetemije*) lek dhe pjesëmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind), që shitesi zotëron në shoqërinë "GMA ALBANIA" sh.p.k

1.2 Shitesi, duhet të përfundojë dhe dorëzojë dhe/ose të bejë të mundur përfundimin dhe dorëzimin e dokumentave të tjerë të nevojshëm sipas legjislacionit shqiptar, në menyrë që t'i kalojë bleresit një titull të tregtueshëm mbi pjesën e kapitalit dhe për të përmbushur siç duhet qëllimin e kësaj Kontrate.

1.3 Shitesi dhe Bleresi, bien dakort për të përfunduar dhe dorëzuar me kerkesë të palës tjetër dhe/ose Shoqërisë, çdo dokument të nevojshëm për të regjistruar 100 % (*njëqind përqind*) të pjesëmarrjes në përqindje të numrit të pjesës në zotërim të bleresit, subjekt të kësaj Kontrate në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Bisnesit dhe të autoriteteve shqiptare të kërkuara sipas legjislacionit Shqiptar.

**Neni 2**  
**Deklarimet dhe Garancitë e Shitesit**

2.1 Shitesi, deklaron se me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB), humbet cilësinë e ortakut në shoqëri për rrjedhim humbet të drejtën e zotërimit të pjesës së saj, me pjesëmarrje në përqindje 100% (*njëqind përqind*), pasi këto të drejta i transferohen Bleresit, i cili fiton të drejtën e zotërimit të pjesës, me pjesëmarrje në përqindje 100% (*njëqind përqind*), të kapitalit të shoqërisë.

2.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitblerje, shoqëria "GMA ALBANIA" sh.p.k, bëhet me një ortak të vetëm, kapitali i së cilës është nënshkruhet dhe zotërohet nga:

**-Z. FABIO NICOLA DE SANTIS, i cili do të zotërojë 100% (njëqind përqind) të numrit të pjesës së shoqërisë të cilat korrespondojnë me 1.00 (një) numër pjesësh, me vlerë nominale në para 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, të kapitalit themeltar të shoqërisë.**

**Kalimi i lekeve do të bëhet cash jashtë zyres noteriale.**

**Neni 3**  
**Deklarimet dhe Garancitë e Bleresit**

3.1 Bleresi, i bën deklaratimet dhe i jep garancitë e mëposhtme Shitesit, secila prej tyre do të jetë e vërtetë dhe e saktë.

3.2 Autorizimi – Të gjitha veprimet, aktet dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe / ose aktet e Shoqërisë që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Shitesit dhe që autorizojnë Bleresin të lidhë dhe të zbatojë këtë Kontratë janë kryer rregullisht.

3.3 Kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Shitesi dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për Bleresin që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.

**Neni 4  
Të ndryshme**



4.1 Çdo shtesë, ndryshim, zgjidhje ose heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate, do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim, me akt noterial dhe nënshkruhet nga ose në emër të secilës Palë.

4.2 Në rast se një dispozitë ose detyrim sipas kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në një juridiksion, vlefshmeria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve në një juridiksion tjetër, nuk do të preket nga një fakt i tillë.

4.3 Palët do të përpiqen të zëvendësojnë një dispozitë të pazbatueshme ose të pavlefshme, në masën më të madhe të mundshme, për të arritur qëllimin e kësaj dispozitë.

**Neni 5  
Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni kompetent**

5.1 Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

5.2 Çdo konflikt në lidhje me nënshkrimin, interpretimin, zbatimin Kontratës do të zgjidhet nga juridiksioni kompetent gjyqësor Shqiptar.

Kontrata e Shitjes të Kuotave, u lexua nga palët të cilët deklarojnë se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht.

Kontratë dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve për çdo aspekt që lidhet me objektin e kësaj.

*Bashkëlidhur kontratës, gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:*

- *Kopje e mjeteve të identifikimit të palëve.*
- *Statuti shoqërisë*
- *Vendim i asamblesë së përgjithëshme.*

**NENI 6**

**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

13.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.



13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**SHITES**

GABRIELLA MALINCONICO

*Gabriella Malinconico*  
*gm*

**GMA Albania**  
**Tirana**  
**L82006005B**

**BLERES**

FABIO NICOLA DE SANTIS

*FABIO NICOLA DE SANTIS*  
*Fabio Nicola De Santis*

**Noter**  
**BELINDA V. CELAJ**  
Noter  
Cel: 069 777 115



Asistoj në përkthim Endi Jirani *[Signature]*

**STATUTI**  
**I SHOQERISE' ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"GMA ALBANIA" SH. P. K.**



Sot ,26/07/2018, ne baze te Kushtetutes dhe te Kodit Civil ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, ne baze te ligjit ne fuqi Nr7512 ,date 08.10.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private Sipermarrjeve te lira dhe aktiviteve private dhe privatizimit" te ligjit N.9901 ,date 14.04.2008, "Per marrredheniet tregtare" dhe ne baze te ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007

"Per qendren kombetare te regjistrimeve" ,qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare,me vullnetin e SAJ TE LIRE ,te nenshkruar ne kete Statut,i cili vlen dhe si Akt Themelimi:

**Gabriella Malinconico** lindur ne Piedimonte Matese (CE),ne Itali me 29/09/1983 bija e Carlo -s me nunmer identiteti AV6221895 e leshuar nga Komuna e Ailano-s (CE) me 05/06/2015;

E cila ka vendosur te hartohet Statuti i nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, aktiviteti i se ciles do te rregullohet mbi bazen e Legjislacionit Shqiptar aktual, sipas Akt Themelimit dhe Statutit te Shoqerise bashkangjitur

**Neni 1 – Emertimi**

1.1 Emertimi i Shoqerise eshte **GMA ALBANIA Sh.p.k.** (e cilesuar me poshte si "Shoqeria").


**Neni 2 – Forma Ligjore**

- 2.1 Shoqeria **GMA ALBANIA Sh.p.k.** eshte e themeluar si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe eshte e rregulluar sipas Statutit te saj si me poshte vijon,dhe ka vlere ne baze te legjislacionit shqiptar dhe si Akt Themelimi
- 2.2 Shoqeria operon ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

**Neni 3 – Selia**

- 3.1 Shoqeria operon me seli ne adresen: Rruga Dervish Hima, Pallati Ambassador 3, Kati III, apt. 23.,Tirane,Shqiperi
- 3.2 Shoqeria mund te kete zyra, dege, perfaqesi dhe agjensi si brenda Shqiperise ashtu edhe jashte shtetit shqiptar.
- 3.3 Mbledhja e Ortakeve,mund te vendose, transferoje dhe/ose te mbylle, si brenda edhe jashte shtetit shqiptar, dege sekondare, filiale,seli, agjensi, zyra perfaqesimi dhe bashkesi lokale te cdo natyre.

#### Neni 4 – Objekti



4.1 mbareshtimin dhe prodhimin, transformimin, paketimin, tregtimin kombëtar dhe jashtë, me shumice dhe pakice, të gjitha llojeve të peshqve dhe kafshëve në përgjithësi: të freskëta, të ngrira, shume të ngrira, megjithatë të ruajtur ose të përgatitur, e produkteve ushqimore, të kafshëve dhe perimeve, gjithashtu të një lloji të veçantë, gjithashtu të destinuara për ushqimin e subjekteve me kushte të veçanta mjekësore;

- blerjen, menaxhimin, marrjen me qira dhe shitjen e ndërtesave, automobilave, dyqaneve, motoçikletave dhe anijeve, te reja dhe te përdorura, luksit dhe jo, për evente mondane, marrëdhëniet me publikun dhe reklamat, promovimet e marketingut ose promovueset për palët e treta ose të veta, të lidhura ose të dobishme për arritjen e qëllimit të korporatës;

- Prodhimin e produkteve të pasticerve të freskëta dhe të ngrira, makarona të freskëta, të ngrira dhe të mbushura me baze sallamesh, mishrash, perimesh, peshku, qumësht dhe nënproduktet e qumështit; - prodhimi i produkteve tipike ushqimore, të qumështit dhe produkteve të qumështit, të salcave të gatshme, të freskëta dhe të ngrira;

- aktivitetet e ftohjes, ngrirjes dhe ngrirjes së thellë e produkteve të mesiperme;

- mbareshtimin e bagetive në përgjithësi dhe në vecanti të buajve, gomere, delet dhe lopet, pula, derra dhe kafshëve në përgjithësi,

- aktivitete catering; aktivitetet e administrimit të ushqimit dhe pijeve për publikun nëpërmjet menaxhimit të aktiviteteve tregtare ambulante dhe fikse, restorante, piceri, taverna, rosticeri, pube, mensa, kafeteri, kioska fikse dhe të levizshme dhe auto-dyqane, pasticeri, gelateri, me ose pa argetim; organizim pritjesh dhe ceremonish.

- kompania mund gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar me ligj, të kryejë të gjitha transaksionet financiare, jo në mënyrë prevalente dhe jo në raport me publikun, komerciale, të luajtshme dhe të patundshme, të lidhura ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, me përjashtim të grumbullimit të kursimeve në publik, ushtrimin e kredisë dhe të çdo forme të qirasë financiare dhe qasjen lehtësisht në çdo formë të fondeve publike kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Projektimi, zhvillimi, zbatimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e impianteve prodhuese, transportin dhe transformimin e energjisë nga burimet konvencionale dhe të rinovueshme, si dhe shpërndarjen dhe shitjen dhe çdo aktivitet të përshtatshëm dhe të nevojshëm për qëllimin e shoqërisë.

- Realizimi ose pjesëmarrja në studime dhe kërkime mbi burimet konvencionale dhe alternative të energjisë

- Kryerja e shërbimeve kartografike, formimi i bazave të të dhënave informatike dhe territoriale, planeve dhe studimeve të fizibilitetit; dizajn paraprak me anketat e tregut; planifikimin përfundimtar dhe ekzekutiv; studimet e ndikimit në mjedis; hartimin dhe menaxhimin e planeve të sigurisë; konsulencë në fusha të ndryshme të teknikave të ndërtimit; platform mbi shtylla (shtylla të ngulura) dhe praktikatat kadastrale të lidhura; realizimin e punimeve publike dhe private.

- Realizimi, marketingu dhe mirëmbajtja e impianteve, makinave dhe prototipeve në sektorët e agroalimentimit, mekanikës, elektronikës, termofluidodinamikës, bioteknologjisë, teknologjisë mjekësore dhe për përmirësimin e qëndrueshmërisë së mjedisit.

- Realizimin, tregtimin dhe mirëmbajtjen e impianteve elektrike me tension të ulët, të mesëm dhe të lartë në vazhdim ose alternativ në sektorin e energjive të,

në sektorin civil, industrial, publik dhe privat, sistemet e ngrohjes, hidraulik, ajër të kondicionuar dhe zjarrfikës, civile dhe industriale, publike dhe private, të strukturave murale, betonit të armuar, çelikut, drurit dhe materialeve inovative për përdorime civile dhe industr



- prodhimin dhe tregtimin e programeve kompjuterike dhe sistemeve hardware në përgjithësi, publike dhe private.
  - zbatimin dhe marketingun e programeve të kërkimit shkencor dhe teknologjik, për llogari të tyre ose në emër të palëve të treta, në sektorët e sipërpërmendur.
  - zhvillimi, zbatimin dhe marketingun e kurseve të trajnimit dhe marketingut që kanë për qëllim rritjen e profesionalizmit të operatorëve në sektorët e lartpërmendur.
  - zhvillimin, zbatimin dhe tregtimin e shërbimeve të mbrojtjes së mjedisit.
  - grumbullimi dhe hedhja e mbeturinave, duke përfshirë të veçanta dhe të çdo lloji, të rëndësishme dhe të rrezikshme.
  - menaxhimin e përfaqësimit dhe / ose agjencisë, brokerimit, ekskluzivitetit, marketingut, marketingut dhe strategjive franchising për produktet e tyre dhe / ose kompani të tjera në të gjithë sektorët.
  - ndërtimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e impianteve komplekse dhe teknologjisë së lartë dhe / ose makinerisë në sektorët e listuar më sipër.
  - aktivitetet të cilat lidhen me përshtatjen e impianteve dhe makinerive në përputhje me ligjet për sigurinë dhe parandalimin e aksidenteve në vendin e punës. -leshimin e garancive, perkrahjet dhe garancitë në përgjithësi edhe për detyrimet dhe borxhet e palëve të treta, si dhe blerjen e fondeve dhe interesave në shoqëri apo ndermarrje të tjera.
2. kompania gjithashtu do të jetë në gjendje të kryejë të gjitha veprimtaritë tregtare, industriale, të pasurive të patundshme, letrave me vlerë dhe financiare:
- ne Shqiperi dhe jashte-Te hap llogari rrjedhese dhe cfaredlloj operacioni tjeter banker, marrin zotërimi dhe interesa në ndermarrje dhe / ose kompani të tjera.
3. së fundi, kompania do të jetë në gjendje të kontraktojë hua me bankat ose institucionet, të japë hua, të japë garanci, të zotohet pasuria e tyre dhe në çdo rast të ketë akses në kredinë e sistemit bankar dhe të paraqesë kërkesa për qasje në fonde publike të pakthyeshme, garantojnë të dyja pasuritë personale dhe reale, të luajtshme dhe të patundshme.

#### **Neni 5 – Kohëzgjatja**

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është vendosur deri më 31 dhjetor 2091 dhe mund të zgjatet.

#### **Neni 6 – Kapitali**

- 6.1. Kapitali është 10.000 (dhjetë mijë) leke i pa paguar i ndarë në 1 (një) kuote me vlerë nominale 10.000 (dhjetë mijë) leke.
- 6.2. Kapitali është plotësisht i regjistruar dhe i leshuar në mënyrë të mëposhtme:
- **Gabriella Malinconico**, jep 10.000 (dhjetë mijë) Lek në para të gatshme .





6.3 Sipas detyrave të lartepërmendura:

- **Gabriella Malinconico** zoteron 1 kuote të barazvlefshme me 100% (njëqind për qind) të kapitalit aksionar.

#### **Neni 7 – Mundësia e transferimit të kuotave**

7.1 Kuotat sociale janë të transferueshme tek palët e treta në përputhje me dispozitat e akteve nënligjore të parashikuara në STATUT.

#### **Neni 8 – Administratorët**

- 8.1 Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të lirë të veprojnë veçmas ose bashkarisht sipas asaj që do të vendoset në rastin e emërimit.
- 8.2 Administratorët nuk duhet të jenë medoemos edhe aksionerë dhe veprojnë në rolin e tyre derisa të japin dorëheqje ose shkarkohen nga Asambleja e Aksionerëve, ose për një periudhë tre-vjeçare (3) me mundësinë për t'u riemëruar.
- 8.3 Përfundimi i mandatit të Administratorëve hyn në fuqi në momentin kur emërohet organi i ri administrues.
- 8.4 Administratorëve u takon të përfaqësojnë Shoqërinë ndaj palëve të treta dhe në gjykim dhe kompetencat më të gjëra administrative, që mund të ushtrohen në harmoni me atë që përcakton artikulli 95 i ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ndryshime pasuese, por në çdo rast, brenda kufijve të përcaktuar në rastin e emërimit dhe nga ky Statut.
- 8.5 Administratorët mund të emërojnë prokure të veçantë për një akt ose një sërë aktesh.
- 8.6 Funkzioni administrativ kryhet sipas një tarife të parashikuar në ligj. Administratorëve u takon rimbursimin e shpenzimeve që kanë në lidhje me funksionin e tyre administrativ.
- 8.7 Me këtë akt themelimi vendoset si Administrator i Shoqërisë:
- Znj. Desjona Zeqo, lindur në Fier më 19/10/1989 e bija e Adrian, banuese në Tiranë me numër pashaportë I96019041W leshuar nga Prefektura e Tiranës më 10/01/2011

#### **Artikull 9 – Gjuha**

- 9.1 Ky Statut hartohet në gjashtë (6) kopje, tri (3) në gjuhën shqipe dhe tri (3) në gjuhën italiane.
- 9.2 Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin e këtij Statuti, versioni i tij në gjuhën italiane do të jetë i vetmi me vlerë të detyrueshme ligjore.
- 9.3 Ky akt miratohet në çdo artikull nga themeluesit e vetëm të Shoqërisë "GMA ALBANIA Sh.p.k." të cilët nënshkruajnë me emrin, mbiemrin dhe firmën e vet të gjitha kopjet.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**Gabriella Malinconico**